

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit
Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Pravna Kancelarija - Legal Office

REFERENCË:	___ 1111-2023
DATË:	05.07.2023
PËR/ZA/TO:	Feride Podvorica, Zv. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor/MD
CC:	Arben Krasniqi, Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm/ZKM; Novitet Nezaj, Drejtor i Departamentit të së Drejtës së BE-së/ZKM; Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore/ZKM; Anita Kalanderi, Zv. Sekretare e Përgjithshme/MD.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arben Krasniqi, zv. Sekretar i Përgjithshëm / Zyra e Kryeministrit; <i>[Signature]</i> Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore / Zyra e Kryeministrit. <i>[Signature]</i>
NGA/OD/FROM:	Labinote Kashtanjeva, zv. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së / Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit. <i>Pën: Novitet Nezaj</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresa përcjellëse për <i>Projektligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare.</i>

E nderuar, znj. Podvorica

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenin 8 par 2.16 si dhe nenin 12 par 1.1 të Rregullores (ZKM) Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, ju përcjellim Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për *Projektligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare.*

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada Government
Zyra e Kryeministrit
Kancelarija Premijera – Office of the Prime Minister
Zyra Ligjore – Pravna Kancelarija – Legal Office

OPINIONI LIGJOR I PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

03.07.2023

Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë, me datë 21.06.2023, bazuar në nenin 7, nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe nenit 13, paragrafit 5 të Rregullores Nr. 13/2023 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, si dhe në pajtim me nenin 12, paragrafin 3 dhe 4, nën paragrafin 4.19 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 për Fushat e Përgjegjësisë të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ka dorëzuar për shqyrtim në Divizionin e të Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit “*Projektligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare*”.

1. SUBJEKTI

Opinion Ligjor për Përputhshmërinë e “*Projektligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare*”, me *acquis* të BE-së.

2. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Në kërkesën e Departamentit Ligjor të Ministrisë së Drejtësisë me *acquis* të BE-së, janë dërguar këto dokumente:

- Drafti final i *Projektligjit* në tre gjuhë (versioni i gjuhës shqipe, angleze, dhe asaj serbe);

- Memorandumi Shpjegues;
- Deklarata e Përputhshmërisë.

3. PREAMBULA

Në pajtim me nenin 7, paragrafin 3 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nenit 3, nën paragrafit 1.3, nenit 13, paragrafi 6, si dhe nenit 21, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenit 30, paragrafit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Divizioni i së Drejtës së BE-së, së Zyrës së Kryeministrit, bazuar në fushëveprimin e kompetencave të tij, me datë 3 korrik 2023, lëshon këtë:

4. OPINION LIGJOR PËR PËRPUTHSHMËRINË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

Kërkesa për **Opinion Ligjor** me *acquis* të BE-së është dërguar në dosje fizike dhe elektronike me datën 26.06.2023, me numër të referencës 1111.

5. HYRJE

Qëllimi i këtij *Projektligji* është rregullimi i shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike dhe private që hartojnë politika dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.¹ Ky *Projektligj* gjithsej përmban 86 nene.

6. PËRMBLEDHJA E AKTEVE TË BE-SË QË RREGULLOJNË FUSHËN E PROJEKT-AKTIT NORMATIV

Legjislacioni primar i BE-së (*acquis*), Traktati për Funkionimin e Bashkimi Evropian², definojnë rolin e Bashkimit Evropian në fushën e mirëqenies sociale dhe asistencës sociale. Nenet

¹ Neni 1 i *Projektligjit*.

² E qasshme përmes: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:12012E/TXT:en:PDF>

3, 151, 153, dhe 156 të TFBE-së, përcaktojnë bazën ligjore në kuadër të legjislacionit primar sa i përket politikave sociale.

Neni 3, paragrafi 2, i TFBE-së, përcakton:

“Bashkimi lufton përjashtimin social dhe diskriminimin, nxit drejtësinë dhe mbrojtjen sociale, barazinë midis grave dhe burrave, solidaritetin midis brezave si dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ai nxit kohezionin ekonomik, social dhe territorial si dhe solidaritetin mes Shteteve Anëtare.”

Duke komplimentuar dispozitën e lartë-cekur, Neni 151 i TFBE-së, përcakton:

“Bashkimi dhe Shtetet Anëtare, duke pasur parasysh të drejtat themelore sociale, siç janë ato të parashikuara në Kartën Sociale Evropiane të nënshkruar në Torino më 18 tetor 1961 dhe në Kartën e Komunitetit për të Drejtat Themelore Sociale të Punonjësve e vitit 1989, kanë si objektiva të tyre nxitjen e punësimit, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të punës, në mënyrë që të mundësohet harmonizimi i tyre gjatë ruajtjes së përmirësimit, mbrojtja e duhur sociale, dialogu midis drejtuesve dhe punonjësve, zhvillimi i burimeve njerëzore me qëllim ruajtjen në periudhë afatgjatë të punësimit të lartë dhe luftën kundër përjashtimit social.”

Ndërsa, Neni 153, paragrafi 1, nën paragrafi (j), përcaktojnë:

Me qëllim arritjen e objektivave të nenit 151, Bashkimi mbështet dhe plotëson aktivitetet e Shteteve Anëtare në fushat e mëposhtme:

(j) *“luftën kundër përjashtimit social.”*

Neni 156 përcakton bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare dhe Komisionit në fushën e politikave sociale:

“Me qëllim arritjen e objektivave të nenit 151 dhe pa cenuar dispozitat e tjera të Traktateve, Komisioni nxit bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare dhe mundëson bashkërendimin e veprimit të tyre në të gjitha fushat e politikave sociale sipas këtij Kreu.”

Lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit social është një nga synimet specifike të politikave sociale të BE-së dhe Shteteve Anëtare të saj. Në përputhje me nenet e lartë-celura, lufta kundër përjashtimit social duhet të arrihet vetëm në bazë të bashkëpunimit jo-legjislativ.

Për më shumë, neni 34 i Kartës për të Drejtat Themelore të Bashkimit Evropian, Titulli IV – Solidariteti, Siguria Sociale dhe Asistenca Sociale, paragrafi 3, përcakton:

“Në mënyrë për ta luftuar përjashtimin social dhe varfërinë, Bashkimi njuh dhe respekton të drejtën për asistencë sociale dhe strehimore në mënyrë që të sigurojë një ekzistencë të denjë për të gjithë ata që u mungojnë burimet e mjaftueshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga e Drejta e Bashkimit si dhe ligjet kombëtare dhe praktikat.”

Ky paragraf specifik është i bazuar në nenin 13 të Kartës Sociale Evropiane si dhe neneve 30 dhe 31 të Kartës Sociale të rishikuar dhe pikës 10 të Kartës së Komunitetit. Bashkimi duhet ta respektojë atë në kuadrin e politikave të bazuara në nenin 153 të TFBE-së.

Në kuadër të luftës ndaj përjashtimit social, Bashkimi Evropian ka prezantuar edhe disa nisma jo-legjislative në mënyrë të arritjes së synimeve dhe objektivave të përcaktuara në nenin 151 të TFBE-së. Këto iniciativa jo-legjislative janë:

I. Strategjia e BE-së mbi të Drejtat e Fëmijëve;³

- Strategjia e BE-së mbi të Drejtat e Fëmijëve ka për synim ndërtimin e një jete sa më të mirë të mundshme për fëmijët në Bashkimin Evropian dhe në mbarë globin. Kjo strategji pasqyron të drejtat dhe rolin e fëmijëve në shoqërinë tonë. Fëmijët janë ata të cilët na

³ E qasshme përmes: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52021DC0142&qid=1621352303074>

frymëzojnë dhe janë në front të ndërgjegjësimit për natyrën dhe krizat e ndryshimeve klimatike, diskriminimin dhe padrejtësinë. Ata janë qytetarë dhe liderë të së sotmes, po aq janë edhe liderë të së nesermes. Kjo strategji synon të përmbushë përgjegjësinë tonë të përbashkët për të bashkuar forcat për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e çdo fëmije; dhe për të ndërtuar së bashku me fëmijët një shoqëri më të shëndetshme, më të qëndrueshme, më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë. Për më shumë kjo strategji ka fokus të veçantë në përfshirjen sociale. Çdo fëmijë ka të drejtën për një standard të përshtatshëm jetese dhe për mundësi të barabarata, që në fazën më të hershme të jetës. Forcimi i përfshirjes socio-ekonomike të fëmijëve është thelbësor për të trajtuar kalimin e varfërisë dhe disavantazheve nëpër breza. Mbrojtja sociale dhe mbështetja për familjet është thelbësore në këtë drejtim.

II. Rekomandimi i Këshillit i datës 30 janar 2023 për të ardhurat minimale adekuate që sigurojnë përfshirje aktive;⁴

- Ky Rekomandim i Këshillit synon të luftojë varfërinë dhe përjashtimin social dhe të ndjekë nivele të larta punësimi duke promovuar mbështetjen e duhur të të ardhurave, veçanërisht me anë të të ardhurave minimale dhe qasje efektive për të mundësuar dhe shërbime thelbësore për personat të cilëve u mungojnë burimet e mjaftueshme dhe duke nxitur integrimin në tregun e punës të atyre që mund të punojnë në përputhje me qasjen e përfshirjes aktive.

III. Rekomandimet e grupit të nivelit të lartë për të ardhmen e mbrojtjes sociale dhe shtetit të mirëqenies;⁵

- Raporti i Grupit të Nivelit të Lartë përcakton 21 rekomandime për të përmirësuar sistemet e mbrojtjes sociale dhe shtetet e mirëqenies në 6 fusha:

- *Mbështetje për fëmijët, të rinjtë dhe familjet;*

⁴ E qasshme përmes: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32023H0203%2801%29>

⁵ E qasshme përmes:

<https://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=89&furtherNews=yes&newsId=10506#:~:text=The%20High%2DLevel%20Group%20report,term%20care%20in%20old%20age>

- Sigurimi i mbrojtjes sociale gjithëpërfshirëse dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- Mbështetjen e të ardhurave adekuate dhe kujdesit afatgjatë me cilësi të lartë në pleqëri;
- Promovimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe me cilësi të lartë që sigurojnë financim të qëndrueshëm për një shtet të mirëqenies së qëndrueshme;
- Rritja e kapaciteteve të BE-së për të siguruar mbrojtje sociale në të ardhmen.

IV. Strategjia Evropiane për Kujdesin;⁶

- Komisioni Evropian ka prezantuar Strategjinë Evropiane të Kujdesit për të siguruar shërbime të kujdesit cilësor, të përballeshëm dhe të qasshëm në të gjithë Bashkimin Evropian dhe për të përmirësuar situatën si për marrësit e kujdesit ashtu edhe për njerëzit që kujdesen për ta, profesionalisht ose jo-formalisht.

V. Deklarata e Lisbonës mbi Platformën Evropiane për Mbrojtjen e të Pastrehëve;⁷

- E nënshkruar me datën 21 qershor 2021 në qytetin e Lisbonës, Shtetet Anëtare akordohen për krijimin e Platformës Evropiane për të Mbrojtjen e të Pastrehëve, e cila si synim kryesor punimin drejt dhënies fund të problemit të strehimit të të pastrehëve.

VI. Rekomandimi i Këshillit (BE) 2021/1004 e datës 14 qershor 2021 për krijimin e një garancie Evropiane për Fëmijët;⁸

- Qëllimi i këtij Rekomandimi është të parandalojë dhe luftojë përjashtimin social duke garantuar qasjen e fëmijëve në nevojë në një sërë shërbimesh kyçe, duke kontribuar në këtë mënyrë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijës duke luftuar varfërinë e fëmijëve dhe duke nxitur mundësi të barabarta. Ky Rekomandim aplikohet për fëmijët në nevojë.

⁶ E qasshme përmes:

<https://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=89&furtherNews=yes&newsId=10382#navItem-relatedDocuments>

⁷ E qasshme përmes: <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1550&langId=en>

⁸ E qasshme përmes: <https://eur-lex.europa.eu/eli/reco/2021/1004/oj>

7. PËRSHKRIMI DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË DËRGUARA ME LEGJISLACIONIN E PROPOZUAR NGA INSTITUCIONI I LINJËS

Nga aspekti përmbajtësor

Dispozitat e këtij *Projektligji* rregullojnë shërbimet sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike dhe private që hartojnë politika dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Dispozitat e projektligjit që përfshijnë *acquis* dhe mbulojnë fushëveprimin e të dhënave personale (neni 4 para 1.9 dhe 1.10), trajtimin e barabarta dhe ndalimin e diskriminimit (neni 7), dhe ofrimin e ndihmës përkatëse për kategoritë e shtetasve të huaj me vendqëndrim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës (neni 11), veçse janë të transpozuar në ligjet bazike.⁹ Rrjedhimisht, roli i Bashkimit Evropian në kuadër të fushëveprimit të shërbimeve sociale është rol plotësues dhe mbështetës.¹⁰ Si rrjedhojë, mbetet si kompetencë e Vendeve Anëtare të rregullojnë politikat e tyre të brendshme sociale. Ndonëse Bashkimi Evropian ka vetëm rol mbështetës ndaj fushës së politikave sociale, ekzistojnë një sërë nismash jo-legjislative të prezantuara nga Bashkimi që synojnë arritjen e objektivave e *acquis* primare të lartë-cekura në pikën 6 të këtij *Opinion*i. Rekomandohet Institucioni përgjegjës që të marrë për bazë këto nisma jo-legjislative si burime komplementare në kuadër të rregullimit të fushëveprimit të këtij *Projektligji* dhe përgjatë nxjerrjes së akteve nënligjore në fushën e shërbimeve sociale.

Nga aspekti teknik

Dokumentacioni shoqërues është pjesërisht në përputhje Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative dhe me Udhëzimet Praktike për Përafrimin e Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Legjislacionin e BE-së. Përgjatë analizës paraprake të Deklaratës së Përputhshmërisë (DeP), vërejmë se nuk janë listuar burimet primare të *acquis* në fushën e politikave sociale. Rekomandohet që Institucioni përgjegjës të plotësoj Deklaratën e Përputhshmërisë, konform pikës 6 të këtij *Opinion*i.

⁹ Shih neni 1 para 2 Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Data e publikimit: 25.02.2019, Gazeta Zyrtare: 6/2019, i qasshëm përmes: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616>. Shih po ashtu, neni 1 para 2 Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Data e publikimit: 26.06.2015, Gazeta Zyrtare: 16/2015, i qasshëm përmes: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>.

¹⁰ Shih neni 4 para 2 pika (b) TFBE.

7. OPINIONI I PËRPUTHSHMËRISË


Ky **Opinion i Përputhshmërisë** është bazuar në përmbajtjen e draftit të projekt-aktit. Përgjegjësia e Divizionit për të Drejtën e BE-së në ZL/ZKM vihet në dukje me opinionin e saj, ndërsa institucioni propozues, është përgjegjës të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP), atëherë kur projekt-akti ndërlihet me transpozim të *acquis* së BE-së. Institucionet e linjës janë përgjegjëse për politikën që ato bëjnë dhe për shkallën e harmonizimit me *acquis* të BE-së. Prandaj, periudhat paraprake nga transpozimi i pjesërisëm deri në transpozim të plotë janë përgjegjësi e organit propozues të projekt udhëzimit. Paraprakisht, plotësimi dhe përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, është përgjegjësi e institucioneve të linjës. *Manuali për Plotësimin e Tabelave dhe Deklaratës së Përputhshmërisë dhe Udhëzime Praktike për Përafrimin e Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Legjislacionin e Bashkimit Evropian*, përmbajnë udhëzime praktike për këtë proces.¹¹

9. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për **Opinion Ligjor për Përputhshmërinë e “Projektligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare”**, konstatojmë se fushëveprimi i këtij *Projektligji* nuk është subjekt i rregullimit të *acquis* të BE-së, dhe si rrjedhojë nuk transponon *acquis* të BE-së.

Me respekt,

Labinote Kashtanjeva

Për: 

Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së

Divizioni për të Drejtën e BE-së

Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit

¹¹ E qasshme përmes: <http://mej-ks.net/sq/dokumente-udhzuese-mbi-procesin-e-prafrimit-ligjor>